



## BIO

# GËZIM KAMENICA

## MSC

### VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

Është angazhuar si asistent-lektor dhe koordinator i laboratorit të stomatologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore në Universitetin Barleti.

### FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Ortodoncia funksionale

Z. Gëzim Kamenica ka përfunduar arsimin e mesëm në Fier dhe më pas vijoi studimet në Akademinë Teologjike në Giessen, Gjermani nga 1993 deri në 1997. Gjatë qëndrimit të tij në Gjermani, ai ka marrë Diplomën e Lartë të Gjuhës Gjermane, Das Grosse Deutsche Sprachdiplom (GDS), nga Instituti Goethe në Frankfurt.

Në vijim Z. Kamenica punoi si lektor i gjuhës gjermane pranë shkollës profesionale "Murialdo" në Fier. Gjithashtu ka përfunduar studimet në degën e Historisë në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

Z. Kamenica u diplomua në Stomatologji në Albanian University në vitin 2014. Ai ka kryer trajnime të vazhdueshme profesionale në fushën e teknikave laboratorike dentare dhe ka marrë specializime në ortodoncinë fikse dhe atë funksionale pranë Dentaurum CDC Center for Dental Communication, në Gjermani. Z. Kamenica ka kontribuar pranë kolegjit Dentar-Al, duke mësuar teknikat e modelimit dentar dhe praktikat e morfologjisë dentare. Ai ka vijuar ushtrimin e profesionit në klinikën e tij dentare, me një fokus të veçantë në ortodoncinë funksionale.